Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 82-83-92/20
Datë/Datum 11.03.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH .nr. 82/20
83/20
92/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik: OE "INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION" SH.P.K & "NAZERI 2000" SH.P.K-Prishtinë, OE "ROJET E NDERIT" SHPK -Prishtinë si dhe ankesës së OE "K.S Besa Security Sh.p.k"-Prishtinë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "COMMANDO Sh.p.k. &Group For Security Sh.p.k. & "AULONA-POL-1 Sh.p.k"-Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës" me nr. të prok:616-19-3238-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, më datën: 03.03.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.<u>APROVOHEN</u>, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik "INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION" SH.P.K & "NAZERI 2000" SH.P.K-Prishtinë, OE "ROJET E NDERIT" SHPK -Prishtinë si dhe OE "K.S Besa Security Sh.p.k"-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës" me nr. të prok:616-19-3238-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë.

II.<u>ANULOHET</u>, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës" me nr. të prok:616-19-3238-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues "INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION" SH.P.K & "NAZERI 2000" SH.P.K-Prishtinë, OE "ROJET E NDERIT" SHPK - Prishtinë si dhe OE "K.S Besa Security Sh.p.k"-Prishtinë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION" SH.P.K & "NAZERI 2000" SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 03.02.2020 me nr. 82/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës" me nr. të prok: 616-19-3238-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 10, 52, 59, 61 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës , Neni 3 neni 4-Rregullat për tenderët jo normalisht të ulët dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik.

Operatori ekonomik ankues OE "ROJET E NDERIT" SHPK -Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 05.02.2020 me nr.83/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës" me nr. të prok:616-19-3238-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 59, 60 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe vendimi i OSHP.

Operatori ekonomik ankues OE "K.S Besa Security Sh.p.k"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 07.02.2020 me nr.92/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës" me nr. të prok:616-19-3238-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 59 dhe nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.02.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 20.02.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove"- PRISHTINË-Ankesa 82/20

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 59 , 61 dhe 72 të LPP-së, me rastin e rekomandimit për kontratë grupit te OE "COMMANDO Sh.p.k. & Group For Security Sh.p.k. & "AULONA-POL-1 Sh.p.k"- Prizren me arsyetimin se: "AK -ka bërë prapë po të njëjtat shkelje duke shpallur këtë herë prapë grupin e OE 'Commando", Aulona POI dhe GFS Security, si të rekomanduar për kontratë siç ka bërë edhe herën e kaluar.

Duke pas parasysh se gjatë procedurës tonë ankimore ne kemi vërejtur se OE i rekomanduar për kontratë ka pas mangësi në ofertën e paraqitur nga ky grup i OE ne kemi vërejtur se kontratat e kërkuara në dosje të tenderit nuk kanë përmbushur kërkesën e dosjes pasi që nuk arrijnë shumën e caktuar të qarkullimit total për 3 vitet e fundit dhe si e tillë oferta e grupit të OE Commando Sh.p.k,Aulona POI dhe GFS Security, është cilësuar si e papërgjegjshme edhe nga eksperti shqyrtues i prokurimit e po ashtu edhe nga Paneli shqyrtues i OSHP-së, mirëpo AK nuk ka respektuar fare vendimin e OSHP nr.735-744757/19 të dt. 21.10.2019 ku janë dhënë rekomandime për vlerësimin e tenderëve dhe ka shkelur prapë LPP-në dhe ka kundërshtuar këtë vendim duke mos e marrë për bazë fare". duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të bazuara sepse grupi i OE të rekomanduar për kontratë nga AK nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme rreth kërkesës "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te

ngjashme,) ne vlere minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë)", grupi i OE te rekomanduar për kontratë nga AK ka bashkangjitur dëshmi listat e kontratave të secilit anëtarë veç e veç lidhur me kontratat e realizuara si dhe kopjet e kontratave dhe referencave, mirëpo në listën e kontratave të anëtarit te konzorciumit "AULONA-POL-1 Sh.p.k" janë përfshirë kontrata te cilat janë realizuar gjatë vitit 2007, 2010, 2015,2016, 2017, 2018 dhe 2019, në referencat e bashkangjitura nuk kanë të specifikuar vlerën financiare të realizuar, janë bashkangjitur kartelat financiare te përpiluara dhe vulosura nga vetë operatori ekonomik, në listën e kontratave të anëtarit te konzorciumit "COMMANDO Sh.p.k. " janë përfshirë kontrata te cilat janë realizuar gjatë vitit 2016, 2017, 2018 dhe 2019, në bazë të listës e cila është sipas Aneksit 6 të dosjes se tenderit si dhe referencave e kontratave te bashkangjitura, shihet se një pjesë e kontratave te lidhura ne vitin 2017, 2018 dhe 2019 janë në implementim e sipër, të papërfunduara si dhe në listën e kontratave të anëtarit te konzorciumit "Group For Security Sh.p.k." janë përfshirë kontrata te cilat janë realizuar gjatë vitit 2014, 2015, 2016 dhe 2017, si dhe kopjet e kontratave dhe referencave, Ndërsa me rastin e rivlerësimit të ofertave AK respektivisht komisioni i vlerësimit të ofertave konform rekomandimeve respektivisht ne zbatim te Vendimit OSHP nr.735-744-757/19 të dt. 21.10.2019, ka kërkuar sqarime shtesë nga grupi i OE te rekomanduar lidhur me dëshmitë/vlerën e kontratave të realizuara te cilat janë prezantuar në listat e kontratave për secilin operator-anëtare të konzorciumit dhe nga të njëjtit ka pranuar dëshmitë- disa transaksionet bankare të anëtarit te konzorciumit "AULONA-POL-1 Sh.p.k", si dhe në vërejtjen përmbyllëse të raportit të vlerësimit e cila është e përshkruar në faqen 15-16 të këtij raporti komisioni ka renditur kontratat me referenca të tre anëtarëve të konzorciumiut("COMMANDO Sh.p.k. & Group For Security Sh.p.k. & "AULONA-POL-1 Sh.p.k") te cilat i kanë marr për bazë dhe kanë konstatuar se vlera totale te referencave te pranueshme është 3,590,237.00 €, mirëpo eksperti shqyrtues konstaton se AK respektivisht komisioni i vlerësimit gabimisht ka konstatuar vlerën totale te kontratave te pranuara prej 736,883.00 € për anëtarin e konzorciumit "COMMANDO Sh.p.k. " sepse nëse mblidhe vlera e kontratave dhe referencave te cilat janë përshkruar dhe pranuar nga komisioni i vlerësimit për anëtarin e konzorciumit "COMMANDO Sh.p.k. " atëherë vlera e përbashkët e këtyre kontratave është e barabartë me 474,115.68 € , po ashtu AK respektivisht komisioni i vlerësimit në kundërshtim më kërkesat e veta të parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka marrë për bazë kontratat dhe referencat e anëtareve te konzorciumit te cilat sipas "listave te kontratave te realizuara" përmbajnë vlera të cilat i përkasin viteve 2010 deri 2016. Eksperti shqyrtues duke u bazuar ne listat e kontratave, te secilit anëtare te konzorciumit te rekomanduar për kontratë nga AK, te cilat janë dorëzuar se bashku me dosjen e tenderit/ofertën financiare konstaton se vlerat e kontratave te cilat AK respektivisht komisioni i vlerësimit i ka pranuar si tërësi, e të cilat sipas "listave te kontratave te realizuara" përmbajnë vlera të cilat i përkasin edhe viteve nga 2010 deri 2016 duke mos përjashtuar faktin se këto kontrata ne vete përmban edhe vlera

te cilat i përkasin periudhës sipas kërkesave te parashtruara nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, janë si vijon:

GFS-ka prezantuar këto kontrata që në vete përmbajnë edhe vlera të cilat i përkasin viteve 2014, 2015 dhe 2016:

-Sigurimi fizik i objekteve te KK-Gjakove-115.000 €

-Sigurimi fizik i objekteve ARD inc 11.491,20 €

-Sigurimi fizik i objekteve ARD inc 67.200,00 €

-Sigurimi fizik i objekteve CCTV 73.555,20 €

COMMANDO-ka prezantuar këto kontrata që në vete përmbajnë edhe vlera të cilat i përkasin vitit 2016:

-Shërbimet e Sigurimit fizik te Objekteve te Trainkos Sh.A 53.800 €

-Sigurimi fizik i objektit MKRS-së 10.000 €

-Sigurimi fizik i objektit KUR Mitrovicë 9.797,76 €

-Sigurimi fizik i objektit Radio Taxi Online 8.913,60 €

-Sigurimi fizik i Evenimenteve Modus SHPK 1.180 €

-Sigurimi fizik i Evenimenteve Gold Poll Club 3.186 €

-Sigurimi fizik i objektit Getoari Shpk 27.230 €

-Sigurimi fizike i objektit G-Project 33.690 €

AULONA-ka prezantuar këto kontrata që në vete përmbajnë edhe vlera të cilat i përkasin vitit 2010-2016:

-Shërbimi i ruajtjes dhe Sigurisë fizike dhe shërbimi i verifikimit te sinjaleve te alarmit-Pro Credit Bank 343.967,40 €

-Sigurimi fizik-FIBANK 178.525,00 €

-Sigurimi fizik-Intesa Sanpolo Bank-582.078,00 €

-Sigurimi fizik AYDINER 962.537,00 €

bazuar në faktet e lartcekur dhe duke pasur parasysh se kërkesa e AK ka qenë që"Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme,) ne vlere minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë)" e që nënkupton se periudha e shkuar tri vjeqare nga data 17.05.2019 kur është bërë publikim i njoftimit për kontratë për këtë aktivitet duhet te merren data të 17.05.2016 deri 17.05.2019, atëherë nëse nuk merren për bazë vlerat e kontratave te paraqitura në listat e grupit të OE të rekomanduar për kontratë, të cilat i përkasin periudhës para datës 17.05.2016 si dhe vlera e kontratave qe janë ende ne implementim atëherë nuk mund të dëshmohet se ky grup i OE ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ka kontrata te implemntuara

me vlerë minimale prej 3,000,000.00 Euro, në tri vitet e fundit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, rreth kalkulimit të çmimeve të ofertave financiare, duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara sepse AK konform rekomandimeve respektivisht ne zbatim te Vendimit të OSHP-së nr.735-744-757/19 të dt. 21.10.2019, ka kërkuar interpretim nga ATK lidhur me formën e "kalkulimit te pagave" dhe konform interpretimit të dhënë nga zyrtaret e ATK-së si dhe konform kalkulimit elektronik i cili gjendet në ëeb faqen e ATK-së ëëë.atk-ks.org, AK respektivisht komisioni i vlerësimit ka nxjerrë çmimin për orë pune duke marr për bazë pagën bruto prej 250 € për një punëtor, (kalkulimi nga ana e komisionit te vlerësimit është përshkruar në faqen 16 të këtij raporti), bazuar mbi këtë kalkulim komisioni vlerësues kanë konstatuar se çmimi prej 1.91 € është çmimi minimal për ore pune dhe pragu që përcakton se cilët tenderues kanë tender të përgjegjshëm.

Mirëpo duke pasur parasysh kërkesën te parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, si vijon:

Kërkesa 2: OE DUHET TE DEKLAROHET SE PUNETOREVE DO TUA PAGUAJ PAGEN MINIMALE BRUTO 250€.

Dëshmia 2: DEKLARATA E NENSHKUAR DHE E VULOSUR NGA OE te cilën deklaratë operatori ekonomik ankues e ka dorëzuar të vulosur dhe nënshkruar se bashku me dosjen e tenderit po ashtu duke pas parasysh sqarimet e dhëna në Aneksin 1 te dosjes së tenderit dhe sqarimeve të dhëna në pyetjet e parashtruara në fazën e njoftimit për kontratë rreth zbatimit të ligjit të punës për orët e punës për një muaj, eksperti shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit AK ka zbatuar vetëm pjesërisht kërkesat e veta të parashtruara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Gjithashtu eksperti shqyrtues konstaton se ndërlidhur me pretendimet e lartcekura qëndron fakt e paraqitura edhe me raportin e ekspertizës 735-744-757/19 te datës 07.11.2019 si vijon: Në këtë aktivitet të prokurimit paraqitet fakti tjetër se AK nuk ka planifikuar buxhet të mjaftueshëm për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse me rastin e inicimit të procedurës në "Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimin e Disponushmeris së Fondeve" është paraqitur buxheti në vlerë prej 2,100,000.00 € (nga 700,000.00 € për secilin vite 2019,2020 dhe 2021) ndërsa në faqen 3 te kësaj deklarate ne pjesën ku parashihet nënshkrimi i kësaj deklaratën nga zyrtari i prokurimit, zyrtari kryesor financiar dhe zyrtari kryesor administrative me qëllim që të konfirmohet edhe njëherë buxheti para se të shpallet vendimi i AK është dhënë deklarata se pajtohen që të shtohet buxheti prej 140,000.00 € për vitin 2019 dhe nga 80,000.00 € për dy vitet tjera, e që nënkupton se aprovimi buxhetor shtesë për këtë aktivitet të prokurimit e rritë buxhetin e planifikuar në vlerë totale prej 2,400,000.00 €. Po ashtu eksperti shqyrtues konstaton se

hartimi i dosjes se tenderit nga ana e AK-së, respektivisht hartimi i tabelës se përshkrimit te çmimit duke përshkruar vetëm numrin e pozitave dhe orëve pa specifikuar numrin minimal të punëtore që duhet të angazhojnë operatoret ekonomik në këtë aktivitet të prokurimit, ka lënë hapësirë që operatoret ekonomik të paraqesin ofertën financiare duke planifikuar numrin e punëtoreve sipas dëshirës se vetë respektivisht aq sa kanë menduar vetë që është e nevojshme të angazhojnë, dhe ky fakt po ashtu paraqet problem për të konstatuar se cila nga ofertat nuk mund ti përmbahen dispozitave të parapara me ligjin e punës. Bazuar në këto fakte eksperti mendon se AK me rastin e vlerësimit nuk ka vepruar konform paragrafit 3 te nenit 52 te LPP-se, ku thuhet "Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkt me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike." Po ashtu është vepruar ne kundërshtim me paragrafin 3 te nenit 56 te LPP-së ku thuhet "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit." Gjithashtu eksperti shqyrtues konstaton se oferta e operatorit ekonomik ankues është më e lirë në vlerë prej 349,920.00 € se sa oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Rojet e Nderit Sh.p.k" – PRISHTINË -Ankesa 83/20

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 7, 59, 60 dhe 72 të LPP-së me arsyetimin se: Shënim nga eksperti: Nga fillimi i faqes 4 deri në faqen 12 të këtij raporti janë paraqitur pretendimet ankimore respektivisht deklarata/arsyetimet e OE ankuese, rreth kërkesave të parashtruara nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit si dhe plotësimin e tyre nga vetë OE, sqarimeve të bëra nga OE ankuese me AK në fazën e njoftimit për kontratë, përshkrimi i interpretimit të ATK-së i dhënë për AK rreth kalkulimit te pagave, përshkrimi i një pjese të vendimit të OSHP-së nr.735-744-757/19 të dt. 21.10.2019 si dhe në të njëjtën pjesë OE ankuese ka paraqitur analizën financiare të ofertës se vetë përmes 5 tabelave- duke pretenduar se të gjitha ofertat tjera pjesëmarrëse ne ketë aktivitet te prokurimit, të cilat kanë oferta më të lira se sa oferta e tyre janë të papërgjegjshme", duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se shumica e e këtyre pretendimeve janë trajtuar dhe vendosur me vendimin e OSHP-së nr.735-744-757/19 të dt. 21.10.2019, ndërsa lidhur me pretendimet rreth mos zbatimit te vendimit të OSHP-së respektivisht pretendimit se AK nuk ka kërkuar sqarim nga operatoret ekonomik pjesëmarrës si dhe rreth interpretimit të ATK-së që

ndërlidhet me kalkulimin e pagave vlejnë të njëjtat përgjigje te dhëna me këtë raport në pretendimin 1 dhe 2 të ankesës 82/20.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "K.S.Besa Security Sh.p.k."- PRISHTINË -Ankesa 92/20

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 7, 59 dhe 60 të LPP-së, me rastin e refuzimit te tenderin tone me arsyetimin: "Përkundër qe ne dosjen e tenderit, AK nuk e ka cekur qe paga prej 250 euro është page baze dhe nuk përfshin orët e natës, me ç'raste është nënkuptuar qe paga e punëtorit bazuar ne punën e zakonshme rotative është 250.00€, Paga bruto mujore nënkupton pagën ne fund te muajit qe i paguhet punëtorit.

Përkundër qe ne, në sqarimet e dërguara tek AK kemi thëne se zëvendësimet I bëjmë me punëtor te tjerë te cilët kane paga me te ultë, siç edhe e lejon ligji i punës dhe vendimi I qeverise me page prej 130.00€. Ne kemi bere kalkuilimin me ore totale duke shfrytëzuar tabelën baze qe AK ka paraqitur e dosje te tenderit përkatësisht ne përshkrim te çmimeve. Me ç'rast janë bere kalkulimet ne Excel, forme ne baze te mënyrës se si jemi ardhur deri tek çmimi përfundimtar dhe përsëri rezultojë qe jemi Brenda buxhetit dhe çmimi është çmim normali tregut. Ne anën tjetër punëtoret tone kane dite pushimi javor, por jo detyrimisht ato dite duhet te jene (e shtune e diele) apo sic e ka quajtur komisioni i AK -se " vikend" qe kupton se s kemi nevoje ti paguajmë shtese/ekstra për pune vikendi kur ata e shfrytëzojnë pushimin javor gjate ditëve tjera te javës! Andaj ne rastin konkret llogariten vetëm festat si pagesë shtesë/ekstra dhe sipas kalendarit zyrtar te festive janë 12 dite gjate vitit, gjegjësisht 1 dite ne muaj. Andaj duke pasur parasysh gjendjen faktike dhe reale te lartcekur ne deklarojmë se: AK Kuvendi Komunës se Prishtinës ka bere shkeljen e Nenit 59, Nenit 60 dhe Nenit 7 nr. 04/L-042 pasi qe: a) AK-Kuvendi I Komunës se Prishtinës ka eliminuar kompaninë tone nga ky aktivitet edhe pse ne kemi qene ne përputhshmëri me e gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit, gjithashtu kompania jone ka dhëne përgjigje sqaruese lidhur me çmimin e ofertuar, çmimi i cili permbush te gjitha kërkesat e AK-se lidhur me pagesën e punëtoreve. b) Kompania jone ka përmbushur te gjitha kriteret për dhënien e kontratës duke qene edhe tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet te ofertuar. c) Kompania jone ndihet e diskriminuar nga vendimi i AK-se pasi qe përkundër se kemi përmbushur te gjitha kërkesat e paraqitura ne njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit, AK ka parapare qe kontratën te ia jep një grupi te operatoreve ekonomik te cilët janë me çmim me te larte për 167,961.60€! d) Çdo Operator Ekonomik qe ka ofertuar çmimin mbi 2,507,913.00€ duhet te konsiderohet si kompani/ OE i përgjegjshëm, për me shume detaje mund ti referoheni dokumentit te bashkangjitur ne këtë ankese (Përshkrimi i çmimeve sipas formatit standard te AK-se) Si përfundim rikujtojmë se AK- KK Prishtine nuk ka respektuar ne perpikmeri vendimin e OSHP-se nr 735-744-757-19 te dates 09.12.2019 pasi qe

OSHP ka kërkuar nga AK përmes vendimit ne fjale qe ti përmbahet ne detaje te gjitha dispozitave te LPP-se, kërkesave te DT dhe te NJK, gjithashtu OSHP ka vërtetuar (ka ardhur ne përfundim) se: ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bere konform nenit 59 te LPP-se dhe njëkohësisht nuk është respektuar neni 60 I LPP-se kriteri kryesor për dhënie te kontratës e qe ka qene tenderi I përgjegjshëm me çmimin me te ulet, shkelje kjo e përsëritur edhe gjate rivlerësimit te ofertave! AK KK-Prishtine ka vepruar me standard te dyfishta pasi qe: Përfshire edhe kontratën e datës 19.08.2019 (me procedure te negociuar) lidhur me ofrimin e shërbimeve te sigurimit me çmimin prej 1.63€ për 1 ore pune, ka vendosur qe kontrata te jepet për zbatim OE qe kane ofertuar me çmimin me te ulte, ndërsa ne këtë aktivitet te cilit po i referohemi AK KK Prishtine çmimin prej 1.83 € për 1 ore pune e quan çmim jonormalisht te ulet! Si përfundim asnjë OE I përgjegjshëm ne këtë aktivitet te prokurimit me çmimin e ofertuar nuk mund te beje përmbushjen e kërkesave ligjore qe rrjedhin nga ligji i punës dhe udhëzimeve administrative 100%! Andaj duhet te merret parasysh ky fakt dhe te shpërblehet me kontrate OE i përgjegjshëm me çmimin me te ulet te ofertuar, pasi qe tani për tani bazuar ne vlerën e parashikuar te projektit dhe çmimet e ofertuara kërkesat ligjore mund te respektohen vetëm pjesërisht!." duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes eksperti shqyrtues konstaton se lidhur me pretendimet e lartë cekura vlejnë të njëjtat përgjigje te dhëna me këtë raport në pretendimin 1 dhe 2 të ankesës 82/20. Gjithashtu eksperti shqyrtues konstaton se oferta e operatorit ekonomik ankues është më e lirë në vlerë prej 167,961.60 € se sa oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen si pjesërisht te bazuara, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe duke pas parasysh se shkeljet e hasura në këtë aktivitet të prokurimit nuk mund te korrigjohen në këtë fazë si dhe më qëllim të trajtimit të barabartë të të gjithë operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të Anulohet, me qëllim që autoriteti kontraktues me rastin e ritenderimit të hartoj kërkesat dhe kritere të matshme në përputhje më aktivitetin e prokurimit si dhe duke respektuar në tërësi ligjin dhe rregullat dytësore për prokurim publik.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 24.02.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "Rojet e Nderit", me datë: 24.02.2020 , me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 03.03.2020, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Në lidhje më pretendimet ankimore të OE ankues **"Internat Security Association Sh.p.k. & Nazeri 2000 Sh.p.k. Dega ne Kosove"**- Prishtinë se AK ka bërë shkelje të nenit 1, 6, 7, 59 , 61 dhe 72 të LPP-së, me rastin e rekomandimit për kontratë grupit te OE "COMMANDO Sh.p.k. & Group For Security Sh.p.k. & "AULONA-POL-1 Sh.p.k"- Prizren me arsyetimin se: "AK -ka bërë prapë po të njëjtat shkelje duke shpallur këtë herë prapë grupin e OE 'Commando", Aulona POI dhe GFS Security, si të rekomanduar për kontratë siç ka bërë edhe herën e kaluar. OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka pas mangësi në ofertën e paraqitur nga ky grup i OE ne kemi vërejtur se kontratat e kërkuara në dosje të tenderit nuk kanë përmbushur kërkesën e dosjes pasi që nuk arrijnë shumën e caktuar të qarkullimit total për 3 vitet e fundit dhe si e tillë oferta e grupit të OE Commando Sh.p.k, Aulona POI dhe GFS Security, është cilësuar si e papërgjegjshme edhe nga eksperti shqyrtues i prokurimit e po ashtu edhe nga paneli shqyrtues i OSHP-së, mirëpo AK nuk ka respektuar fare vendimin e OSHP nr. 735-744757/19 të dt. 21.10.2019 ku janë dhënë rekomandime për vlerësimin e tenderëve dhe ka shkelur prapë LPP-në dhe ka kundërshtuar këtë vendim duke mos e marrë për bazë fare".

Paneli shqyrtues konstaton se duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të bazuara sepse grupi i OE të rekomanduar për kontratë nga AK nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme rreth kërkesës "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme,) ne vlere minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontratë)", grupi i OE te rekomanduar për kontratë nga AK ka bashkangjitur dëshmi listat e kontratave të secilit anëtarë veç e veç lidhur me kontratat e realizuara si dhe kopjet e kontratave dhe referencave, mirëpo në listën e kontratave të anëtarit te konzorciumit "AULONA-POL-1 Sh.p.k" janë përfshirë kontrata te cilat janë realizuar gjatë vitit 2007,

2010, 2015,2016, 2017, 2018 dhe 2019, në referencat e bashkangjitura nuk kanë të specifikuar vlerën financiare të realizuar, janë bashkangjitur kartelat financiare te përpiluara dhe vulosura nga vetë operatori ekonomik, në listën e kontratave të anëtarit te konzorciumit "COMMANDO Sh.p.k." janë përfshirë kontrata te cilat janë realizuar gjatë vitit 2016, 2017, 2018 dhe 2019, në bazë të listës e cila është sipas Aneksit 6 të dosjes se tenderit si dhe referencave e kontratave te bashkangjitura, shihet se një pjesë e kontratave te lidhura ne vitin 2017, 2018 dhe 2019 janë në implementim e sipër, të papërfunduara si dhe në listën e kontratave të anëtarit te konzorciumit "Group For Security Sh.p.k." janë përfshirë kontrata te cilat janë realizuar gjatë vitit 2014, 2015, 2016 dhe 2017, si dhe kopjet e kontratave dhe referencave, ndërsa me rastin e rivlerësimit të ofertave AK respektivisht komisioni i vlerësimit të ofertave konform rekomandimeve respektivisht ne zbatim te Vendimit OSHP nr. 735-744-757/19 të dt. 21.10.2019, ka kërkuar sqarime shtesë nga grupi i OE te rekomanduar lidhur me dëshmitë/vlerën e kontratave të realizuara te cilat janë prezantuar në listat e kontratave për secilin operator-anëtar të konzorciumit dhe nga të njëjtit ka pranuar dëshmitë- disa transaksione bankare të anëtarit te konzorciumit "AULONA-POL-1 Sh.p.k", si dhe në vërejtjen përmbyllëse të raportit të vlerësimit e cila është e përshkruar në faqen 15-16 të këtij raporti, komisioni ka renditur kontratat me referenca të tre anëtarëve të konzorciumiut ("COMMANDO Sh.p.k. & Group For Security Sh.p.k. & "AULONA-POL-1 Sh.p.k") te cilat i kanë marr për bazë dhe kanë konstatuar se vlera totale te referencave te pranueshme është 3,590,237.00 €, mirëpo AK respektivisht komisioni i vlerësimit gabimisht ka konstatuar vlerën totale te kontratave te pranuara prej 736,883.00 € për anëtarin e konzorciumit "COMMANDO Sh.p.k. " sepse nëse mblidhet vlera e kontratave dhe referencave te cilat janë përshkruar dhe pranuar nga komisioni i vlerësimit për anëtarin e konzorciumit "COMMANDO Sh.p.k. " atëherë vlera e përbashkët e këtyre kontratave është e barabartë me 474,115.68 €, po ashtu AK respektivisht komisioni i vlerësimit në kundërshtim më kërkesat e veta të parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka marrë për bazë kontratat dhe referencat e anëtareve te konzorciumit te cilat sipas "listave te kontratave te realizuara" përmbajnë vlera të cilat i përkasin viteve 2010 deri 2016. Paneli shqyrtues duke u bazuar ne listat e kontratave, te secilit anëtar te konzorciumit te rekomanduar për kontratë nga AK, te cilat janë dorëzuar se bashku me dosjen e tenderit/ofertën financiare konstaton se vlerat e kontratave te cilat AK respektivisht komisioni i vlerësimit i ka pranuar si tërësi, e të cilat sipas "listave te kontratave te realizuara" përmbajnë vlera të cilat i përkasin edhe viteve nga 2010 deri 2016 duke mos përjashtuar faktin se këto kontrata ne vete përmbajnë edhe vlera te cilat i përkasin periudhës sipas kërkesave te parashtruara nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit,

Duke pasur parasysh faktin se kërkesa e AK ka qenë "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme,) ne vlere minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë)" e që nënkupton se periudha e shkuar

tri vjeçare nga data 17.05.2019 kur është bërë publikim i njoftimit për kontratë për këtë aktivitet duhet te merren data të 17.05.2016 deri 17.05.2019, atëherë nëse nuk merren për bazë vlerat e kontratave te paraqitura në listat e grupit të OE të rekomanduar për kontratë, të cilat i përkasin periudhës para datës 17.05.2016 si dhe vlera e kontratave qe janë ende ne implementim atëherë nuk mund të dëshmohet se ky grup i OE ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ka kontrata te implemntuara me vlerë minimale prej 3,000,000.00 euro, në tri vitet e fundit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, rreth kalkulimit të çmimeve të ofertave financiare, duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendes paneli shqyrtues konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të bazuara sepse AK konform rekomandimeve respektivisht ne zbatim te Vendimit të OSHP-së nr. 735-744-757/19 të dt. 21.10.2019, ka kërkuar interpretim nga ATK lidhur me formën e "kalkulimit te pagave" dhe konform interpretimit të dhënë nga zyrtaret e ATK-së si dhe konform kalkulimit elektronik i cili gjendet në ueb faqen e ATK-së www.atk-ks.org, AK respektivisht komisioni i vlerësimit ka nxjerrë çmimin për orë pune duke marr për bazë pagën bruto prej 250 € për një punëtor, (kalkulimi nga ana e komisionit te vlerësimit është përshkruar në faqen 16 të këtij raporti), bazuar mbi këtë kalkulim komisioni vlerësues kanë konstatuar se çmimi prej 1.91 € është çmimi minimal për ore pune dhe pragu që përcakton se cilët tenderues kanë tender të përgjegjshëm.

Mirëpo duke pasur parasysh kërkesën te parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, si vijon:

Kërkesa 2: OE duhet te deklarohet se punëtoreve do tua paguaj pagën minimale bruto 250€, dëshmia 2: deklarata e nënshkruar dhe e vulosur nga OE, te cilën deklaratë operatori ekonomik ankues e ka dorëzuar të vulosur dhe nënshkruar se bashku me dosjen e tenderit po ashtu duke pas parasysh sqarimet e dhëna në Aneksin 1 te dosjes së tenderit dhe sqarimeve të dhëna në pyetjet e parashtruara në fazën e njoftimit për kontratë rreth zbatimit të ligjit të punës për orët e punës për një muaj, paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit AK ka zbatuar vetëm pjesërisht kërkesat e veta të parashtruara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Paneli shqyrtues konstaton se pretendimet e lartcekura janë paraqitur nga eksperti shqyrtues edhe në raportin e ekspertizës 735-744-757/19 te datës 07.11.2019 ku është konstatuar se në këtë AK nuk ka planifikuar buxhet të mjaftueshëm për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit, sepse me rastin e inicimit të procedurës në "Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimin e Disponushmeris së Fondeve" është paraqitur buxheti në vlerë prej 2,100,000.00 € (nga 700,000.00 € për secilin vite 2019,2020 dhe 2021) ndërsa në faqen 3 te kësaj deklarate ne pjesën ku parashihet nënshkrimi i kësaj deklaratën nga zyrtari i prokurimit, zyrtari kryesor financiar dhe zyrtari kryesor administrative me qëllim që të konfirmohet edhe njëherë

buxheti para se të shpallet vendimi i AK është dhënë deklarata se pajtohen që të shtohet buxheti prej 140,000.00 € për vitin 2019 dhe nga 80,000.00 € për dy vitet tjera, e që nënkupton se aprovimi buxhetor shtesë për këtë aktivitet të prokurimit e rritë buxhetin e planifikuar në vlerë totale prej 2,400,000.00 €, kështu qe oferta e Operatorit Ankues është nen buxhetin e planifikuar me rritje te Autoritetit Kontraktues. Gjithashtu oferta e operatorit ekonomik ankues është më e lirë në vlerë prej 349,920.00 € se sa oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues **"Rojet e Nderit Sh.p.k"** – Prishtinë -Ankesa 83/20, se AK ka bërë shkelje të nenit 7, 59, 60 dhe 72 të LPP-së me arsyetimin se: Nga fillimi i faqes 4 deri në faqen 12 të raportit të ekspertizës janë paraqitur pretendimet ankimore respektivisht deklarata/arsyetimet e OE ankuese, rreth kërkesave të parashtruara nga AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit si dhe plotësimin e tyre nga vetë OE, sqarimeve të bëra nga OE ankues me AK në fazën e njoftimit për kontratë, përshkrimi i interpretimit të ATK-së i dhënë për AK rreth kalkulimit te pagave, përshkrimi i një pjese të vendimit të OSHP-së nr. 735-744-757/19 të dt. 21.10.2019 si dhe në të njëjtën pjesë OE ankues ka paraqitur analizën financiare të ofertës se vetë përmes 5 tabelave- duke pretenduar se të gjitha ofertat tjera pjesëmarrëse ne ketë aktivitet te prokurimit, të cilat kanë oferta më të lira se sa oferta e tyre janë të papërgjegjshme", Paneli shqyrtues konstaton se shumica e këtyre pretendimeve janë trajtuar dhe vendosur me vendimin e OSHP-së nr. 735-744-757/19 të dt. 21.10.2019, ndërsa lidhur me pretendimet rreth mos zbatimit te vendimit të OSHP-së respektivisht pretendimit se AK nuk ka kërkuar sqarim nga operatoret ekonomik pjesëmarrës si dhe rreth interpretimit të ATK-së që ndërlidhet me kalkulimin e pagave vlejnë të sqaruara si me lart në pretendimin 1 dhe 2 të ankesës 82/20.

Në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues **"K.S.Besa Security Sh.p.k."- Prishtinë -Ankesa 92/20** se AK ka bërë shkelje të nenit 7, 59 dhe 60 të LPP-së, me rastin e refuzimit te tenderin tone me arsyetimin: "Përkundër qe ne dosjen e tenderit, AK nuk e ka cekur qe paga prej 250 euro është page baze dhe nuk përfshin orët e natës, me ç'rast është nënkuptuar qe paga e punëtorit bazuar ne punën e zakonshme rotative është 250.00€, paga bruto mujore nënkupton pagën ne fund te muajit qe i paguhet punëtorit. Përkundër qe ne, në sqarimet e dërguara tek AK kemi thëne se zëvendësimet i bëjmë me punëtor te tjerë te cilët kane paga me te ultë, siç edhe e lejon ligji i punës dhe vendimi i qeverise me page prej 130.00€. Ne kemi bere kalkulimin me ore totale duke shfrytëzuar tabelën baze qe AK ka paraqitur e dosje te tenderit përkatësisht ne përshkrim te çmimeve, me ç'rast janë bere kalkulimet ne Excel, forme ne baze te mënyrës se si jemi ardhur deri tek çmimi përfundimtar dhe përsëri rezultojë qe jemi Brenda buxhetit dhe çmimi është çmim normal i tregut. Ne anën tjetër punëtoret tone kane dite pushimi javor, por jo detyrimisht ato dite duhet te jene e shtune e diele) apo siç e ka quajtur komisioni i AK -se "vikend" qe

kupton se kemi nevoje ti paguajmë shtese/ekstra për pune vikendi kur ata e shfrytëzojnë pushimin javor gjate ditëve tjera te javës! Andaj ne rastin konkret llogariten vetëm festat si pagesë shtesë/ekstra dhe sipas kalendarit zyrtar te festive janë 12 dite gjate vitit, gjegjësisht 1 dite ne muaj. Andaj duke pasur parasysh gjendjen faktike dhe reale te lartcekur ne deklarojmë se: AK Kuvendi Komunës se Prishtinës ka bere shkeljen e Nenit 59, Nenit 60 dhe Nenit 7 nr. 04/L-042 pasi qe: a) AK-Kuvendi i Komunës se Prishtinës ka eliminuar kompaninë tone nga ky aktivitet edhe pse ne kemi qene ne përputhshmëri me e gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit, gjithashtu kompania jone ka dhëne përgjigje sqaruese lidhur me çmimin e ofertuar, çmimi i cili përmbush te gjitha kërkesat e AK-se lidhur me pagesën e punëtoreve. b) Kompania jone ka përmbushur te gjitha kriteret për dhënien e kontratës duke qene edhe tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet te ofertuar. c) Kompania jone ndihet e diskriminuar nga vendimi i AK-se pasi qe përkundër se kemi përmbushur te gjitha kërkesat e paraqitura ne njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit, AK ka parapare qe kontratën te ia jep një grupi te operatoreve ekonomik te cilët janë me çmim me te larte për 167,961.60€! d) Çdo Operator Ekonomik qe ka ofertuar çmimin mbi 2,507,913.00€ duhet te konsiderohet si kompani/ OE i përgjegjshëm, për me shume detaje mund ti referoheni dokumentit te bashkangjitur ne këtë ankese (Përshkrimi i çmimeve sipas formatit standard te AK-se) Si përfundim rikujtojmë se AK- KK Prishtine nuk ka respektuar në përpikëri vendimin e OSHP-se nr 735-744-757-19 te datës 09.12.2019 pasi qe OSHP ka kërkuar nga AK përmes vendimit ne fjale qe ti përmbahet ne detaje te gjitha dispozitave te LPP-se, kërkesave te DT dhe te NJK, gjithashtu OSHP ka vërtetuar se: ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bere konform nenit 59 te LPP-se dhe njëkohësisht nuk është respektuar neni 60 I LPP-se kriteri kryesor për dhënie te kontratës e qe ka qene tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet, shkelje kjo e përsëritur edhe gjate rivlerësimit te ofertave! AK KK-Prishtine ka vepruar me standard te dyfishta pasi qe: Përfshire edhe kontratën e datës 19.08.2019 (me procedurë te negociuar) lidhur me ofrimin e shërbimeve te sigurimit me çmimin prej 1.63€ për 1 ore pune, ka vendosur qe kontrata te jepet për zbatim OE qe kane ofertuar me çmimin me te ulte, ndërsa ne këtë aktivitet te cilit po i referohemi AK KK Prishtine çmimin prej 1.83 € për 1 ore pune e quan çmim jonormalisht te ulët! Si përfundim asnjë OE i përgjegjshëm ne këtë aktivitet te prokurimit me çmimin e ofertuar nuk mund te beje përmbushjen e kërkesave ligjore qe rrjedhin nga ligji i punës dhe udhëzimeve administrative 100%! Andaj duhet te merret parasysh ky fakt dhe te shpërblehet me kontrate OE i përgjegjshëm me çmimin me te ulet te ofertuar, pasi qe tani për tani bazuar ne vlerën e parashikuar te projektit dhe çmimet e ofertuara kërkesat ligjore mund te respektohen vetëm pjesërisht!."

Paneli shqyrtues konstaton se lidhur me pretendimet e lartë cekura vlejnë të gjitha konstatimet e dhëna sipas ankesës së OE ankues "Rojet e Nderit".

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Kuvendi Komunal Prishtinë,

1x1 OE - "INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION" SH.P.K & "NAZERI 2000" SH.P.K-Prishtinë,

1x1 OE "ROJET E NDERIT" SHPK –Prishtinë,

1x1 OE "K.S Besa Security Sh.p.k"-Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së,

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.